




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Duke u bazuar në Rregulloren Nr.01/2022 për Avancimin ne Karrierë dhe Transferimin e Nëpunësve në Komisionin e Pavarur të Mediave , KPM shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e Lartë i Logjistikës
Klasa e pozitës : Profesional 1
Koeficienti : 5.8
Nr i kërkuar : 1
Departamenti: Departamenti i Administratës dhe Financave
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat të caktuar
Numri i referencës: 2311/1041/ADM/n.a
Vendi i punës: Prishtinë



Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me udhëheqësin për zbatimin e objektivave ne realizmin e shërbimeve të logjistikës
2. Ofron mbështetje teknike dhe operative për institucion për zbatimin e praktikave më të mira menaxhuese të logjistikës, sistemeve dhe procedurave;
3. Vlerëson sistemet ekzistuese të operacioneve logjistike dhe rekomandon masa përmirësuese që duhet të ndërmerren;
4. Menaxhon pranimin, procedimin dhe shpërndarjen e paisjeve dhe mallrave sipas kërkesave të aprovuara.
5. Procedon te gjitha kërkesat, faturat për mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjeve te teknologjisë informative shpenzimeve te telefonit, karburanteve dhe pajisen me inventar;
6. Sigurojë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e iniciativave dhe procedurave të reja që lidhen me logjistikën;
7. Harton, zbaton dhe menaxhon kontratat për furnizime që ndërlidhen me logjistikën kur është e nevojshme;
8. Kompletton dhe mirëmban të dhënat për furnizim me material.
9. Sipas nevojës, rishikon dhe kontrollon punën e zyrtarëve të tjerë profesional të nivelit më të ulët, duke sygjerruar dhe udhëzuar kryerjen e punëve profesionale.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

1. Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, Fakultetit Juridik, Ekonomik, Administrate Publike.
2. Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

1. Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
2. Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërliidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
3. Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
4. Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Jetëshkrimi - CV; Letra motivuese; Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmive mbi trajnimet relevante; Kopjet e dëshmisë së punësimit si dhe kopje të vlerësimeve të punës për dy (2) vitet e fundit. Në rastet kur diploma është e lëshuar nga një shtet jashtë Kosovës, atëherë duhet të jetë e barasvlershme dhe e njohur me ligjet në Kosovë.

“Komisioni i Pavarur i Mediave ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit e Zyrës Ekzekutive dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë nëpunësit, dhe se komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në të gjitha strukturat dhe njësitë organizative të Zyrës Ekzekutive.”

Afati i aplikimit është prej 01/11/2023 deri më datë 08/11/2023, deri në orën 16:00

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikacionet dorëzohen në Komisionin e Pavarur të Mediave, Rr. Perandori Justinian nr.124. “Qyteza Pejton” 10000 Prishtinë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: +383 38 245 031, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KPM-së, në linkun: www.kpm-ks.org